

## **Detyra nr. 1**

### **Në tekstin në vazhdim caktojini tri llojet e propagandës - politike, ekonomike dhe religjioze**

#### **Me humanizëm deri në përjetësi**

Koncerti për nder të Toshes do të mbahet më 24 janar, në vigjilje të ditëlindjes së tij të 29-të, ndërsa këtë herë do të mbledhen mjete për shugurimin e manastirit “Shën Shndërrimi“ në Krushevë.

Me moton “Me humanizëm deri në përjetësi”, më 24 janar, në sallën “Boris Trajkovski” në Shkup do të mbahet koncerti për nder të yllit maqedonas të muzikës, i cili herët ndërroi jetë, Toshe Proeski. Këtë herë do të mbledhen mjete për shugurimin e manastirit ”Shën Shndërrimi” në Krushevë, që të realizohet edhe një dëshirë e madhe e këngëtarit. Veç tjerash, në këtë koncert do të promovohen 8 këngët e papublikuara, të komponuara nga Toshe, më tej të përpunuara nga bashkëpunëtorët e tij, në interpretim të këngëtarëve me të cilët ka bashkëpunuar ose ka pasur për qëllim të bashkëpunonte.

-Siç publikuam para disa muajve, vendosëm që koncerti tradicional për nder të Toshes të mbahet në ditëlindjen e tij, më 25 janar, në vend të ditës së koncertit të tij të fundit. Në fund vendosëm që më 24 janar, një ditë para ditëlindjes, për shkak se më 25 farefisi dhe miqtë e tij më të afërt do të duan të jenë në Krushevë, shpjegoi Andrej Nikollovski, drejtor ekzekutiv i fondacionit ndërkombëtar ”Toshe Proeski” në konferencën e djeshme për shtyp.

Sipas Nikollovskit, për ditëlindjen e 29-të Toshes do t’i plotësohen dy dëshira - manastiri “Shën Shndërrimi” të shugurohet dhe të publikohen 8 kompozimet e tij autoriale. Pastaj do të mbetet që të vendoset kryqi i ndritshëm 33-metërs në afërsi të manastirit. Këngët, ndërkaq, të cilat si premierë do të interpretohen në koncert, janë zgjedhur nga materiali që Toshe e la pas vetes, ato janë përpunuar më tej nga tekstshkruesit dhe aranzhuesit me të cilët ai ka bashkëpunuar, ndërsa interpretimin do ta bëjnë këngëtarët me të cilët ai ka incizuar, ka planifikuar të incizojë duet, ose u ka premtuar se do t’u dhurojë këngë - Toni Cetinski, Boris Novkoviq, Nina Badriq, Aki Rahimovski, Elena Ristevska, Kaliopi, Jelena Tomasheviq dhe Hari Mata Hari.

Përveç këtyre 8 kompozicioneve, do të promovohet edhe kënga “Josh uvek sanjam da smo zajedno“ (Ende po ëndërroj se jemi bashkë), të cilën Toshe e ka incizuar në periudhën derisa e ka bërë gati materialin për albumin “Lojra pa kufij”. Atëherë, bashkë me produksionin “Avord” dhe menaxheren Liljana Petroviq, kishin vendosur që kjo këngë të mos integrohej në album, por të mbetej për ndonjë paraqitje tjetër në festivale. Spotin për të e ka punuar studio ”DM”, bashkëpunëtor i tij shumëvjeçar. Gjithashtu, momentalisht është në përpunim edhe videoshënimi për këngën “Guilts” nga albumi në gjuhën angleze ”The Hadest Thing”.

Detaje të tjera në lidhje me programin e koncertit do të zbulohen më 5 janar.

Si edhe vitin e kaluar, koncerti sërish do të ketë mbështetjen e Qeverisë së Maqedonisë dhe të Ministrisë së Kulturës.

- Koncerti më 24 janar do të jetë një xixë shprese, një dimesion i vërtetë i fjalëve dashuri dhe humanitet - tha ministrja e Kulturës, Elizabeta Kançevska-Milevska, dhe shtoi se gjatë vitit 2010 do të duhet të përfundojë e të hapet shtëpia-përkujtimore e Toshes në Gumenje, në Krushevë.

Përveç Ministrisë, këtë herë si mbështetës paraqitet edhe “EVN Maqedoni”, e cila tërësisht e mori përgjegjësinë për ndriçimin e manastirit. Bëhet fjalë për ndërtimin e instalimeve elektrike kabllore në një gjatësi prej 7 kilometrash, nëpër një terren malor të pakalueshëm dhe për ngritjen e trafostacioneve. “EVN Maqedoni” merr pjesë me donacion financiar, por edhe me punë teknike në projekt.

- Projekti është gati, përgatitjet për t’ia filluar punës janë duke ecur. Jo vetëm mjete, por edhe shumë dashuri jemi duke dhënë për të ndriçuar manastirin. E kemi privilegj ta punojmë këtë projekt - tha Lençe Karpuzovska, drejtore e komunikimeve në “EVN”.

Koncertin e përgatit fondacioni “Toshe Proeski”, me mbështetjen e produksionit “Avord” dhe të menaxheres Petroviq. Prej mbrëmë në TV-eter emetohet edhe reklama, ku është montuar edhe zëri i Toshes, i cili fton tërë Maqedoninë për t’i ndihmuar që drita të arrijë në manastirin e Krushevës.

**Burimi: Nova Makedonija (26.12.2009)**